

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI EKONOMIK



**VLERËSIMI I PËRCAKTUESVE TË
MIRËQENIES SUBJEKTIVE TË TË
VETËPUNËSUARVE**

ALBANË GASHI

2024

Abstrakt

Ndërmarrësia është konsideruar historikisht si kyçe për zhvillimin e ekonomisë dhe krijimin e pasurisë. Megjithatë, të qenurit ndërmarrës është sipërmarrje sfiduese, e cila shtron pyetjen nëse ndërmarrësit arrijnë të ruajnë mirëqenien e tyre gjatë ndjekjes së veprimtarive të tyre sipërmarrëse dhe cilët faktorë ndikojnë në të. Edhe pse, mirëqenia në kontekstin e ndërmarrësisë është aq e rëndësishme saqë mungesa e saj mund të çojë në djegie sipërmarrëse dhe të ndikojë në ekzistencën e biznesit, kuptimi i përcaktuesve të mirëqenies së të vetëpunësuarve është ende i mangët. Prandaj, qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë mirëqenien subjektive të të vetëpunësuarve, në formën e kënaqësisë me jetën. Ky studim paraqet një qasje analitike në shumë nivele që shpjegon marrëdhënien midis variablave të nivelit individual (demografinë, karakteristikat personale të zhvilluara dhe domenet e kënaqësisë) dhe variablave institucionale në nivel vendi (stabiliteti politik, indeksi i konrupsionit të përceptuar, rregullatori i taksave, liria e biznesit dhe Bruto Produkti Vendor) me mirëqenien subjektive të të vetëpunësuarve. Modeli është testuar me të dhëna nga anketa Life in Transition Survey (LiTS III) për 34 shtete duke përdorur analizën e multilevel mixed-effects logistic regression. Të gjeturat tregojnë se faktorët individualë ashtu edhe ata qeverisës luajnë rol signifikant në formësimin e mirëqenies subjektive të ndërmarrësve. Faktorët më të rëndësishëm që nxisin kënaqësinë e jetës së të vetëpunësuarve në nivel individual janë kënaqësia në punë, statusi financiar, besimi i përgjithësuar, optimizmi dhe pozita sociale. Në nivel institucional, liria e biznesit dhe stabiliteti politik rezultuan të jenë më të rëndësishmet, pasuar nga indeksi i korrupsionit të përceptuar dhe rregullatori i taksave. Bruto Produkti Vendor, nga ana tjetër, nuk tregoi signifikancë në këtë drejtim.

Në përgjithësi, ky hulumtim rrit të kuptuarit në lidhje me mirëqenien subjektive në fushën e ndërmarrësisë, me implikime të rëndësishme për teorinë dhe praktikën e ndërmarrësisë në kornizat e studimit të mirëqenies dhe njëkohësisht ofron rekomandime përkatëse për politikëbërësit.

Fjalë kyçe: Të vetëpunësuarit, ndërmarrësi, kënaqësia me jetën, mirëqenia subjektive, variabla në nivel individual, variabla në nivel institucional